

Udhëzues për media

Raportimi etik për zgjedhjet



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Ky udhëzues për mbulimin mediatik të zgjedhjeve përmban parimet themelore profesionale dhe etike, të cilave gazetarët dhe redaktorët duhet t'iu përmbahen kur raportojnë për zgjedhjet.

Udhëzimet iu dedikohen mediave të printuara dhe online, por mund t'iu shërbejnë edhe të gjitha mediave të tjera. Udhëzuesi është hartuar bazuar në standardet etike gazetareske, rekomandimet e organizatave ndërkombëtare të medias, si dhe praktikrat e mira të raportimit.

Po ashtu, udhëzuesi bazohet në Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, por edhe në dokumente të tjera që kanë të bëjnë me etikën e mediave.

Mediat inkurajohen që brenda redaksive të zhvillojnë udhëzime shtesë për raportimin e zgjedhjeve dhe të përfshijnë standarde vetërregulluese profesionale dhe etike gjatë raportimit.

Etika e gazetarisë dhe zgjedhjet

Raportimi për zgjedhjet është pjesë e rëndësishme e lirisë së shprehjes. Ashtu siç zgjedhjet duhet të jenë plotësisht të lira dhe demokratike, i tillë duhet të jetë edhe mbulimi i tyre. Gjatë raportimit mediat dhe gazetarët nuk duhet ta cenojnë etikën profesionale nëpërmjet shtrembërimit të fakteve.

Mediat duhet t'i sigurojnë në mënyrë profesionale informacionet dhe opinionet, duke shmangur raportimin pa verifikuar faktet. Akuzat dhe fjalimet ofenduese nuk duhet publikuar pa i mundësuar palës tjetër që t'i komentojë apo të jep përgjigje përkatëse.

Vetëm me një gazetari të përgjegjshme votuesve mund t'i ndihmohet që të marrin vendime të lira. Paanshmëria është aspekt i rëndësishëm i përgjegjësisë gazetareske. Mediat dhe gazetarët nuk duhet të kenë qëndrim arbitrar ndaj asnjë subjekti. Detyra e tyre është të parashtrojnë pyetje në emër të votuesve, t'i krahasojnë përgjigjet, të prezantojnë opinionet të ndryshme dhe të ofrojnë informacione për prapaskenën e ngjarjeve, në mënyrë që publiku të jetë i vetëdijshëm për kontekstin e lajmit.

Saktësia është një aspekt tjetër i rëndësishëm i përgjegjësisë së gazetarëve. Lajmi duhet të jetë i saktë edhe nga aspekti i vendosjes së informacioneve në një kontekst të caktuar, si dhe vënies së theksit mbi ngjarje dhe tema të rëndësishme.

Por, jo vetëm gazetarët janë ata që duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e gazetarisë së përgjegjshme. Redaktorët luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e përmbajtjeve mediatike. Ata duhet të synojnë që gjatë mbulimit të zgjedhjeve të sigurojnë saktësi, paanshmëri dhe balancim.

Gazetarët duhet të kenë kujdes që të mos komprometojnë kredibilitetin e tyre moral dhe profesional, si dhe të medias në të cilën punojnë, duke pranuar të bëhen pjesë e skemave potenciale korruptive.

Mediat dhe gazetarët duhet të respektojnë standardet e mirësjelljes dhe të diversitetit etnik, kombëtar, racor, gjinor, seksual, kulturor e fetar, duke mos inkurajuar qëllimisht ose tërthorazi diskriminimin dhe jotolerancën.

Mediat dhe gazetarët duhet të tregojnë transparencë të plotë në mbledhjen, publikimin dhe analizimin e informacionit, në përputhje me kodet e etikës.

- 1** Mediat duhet të informojnë publikun në mënyrë gjithëpërfshirëse për procesin zgjedhor, duke ofruar informacione të plota dhe të sakta. Fushata duhet të mbulohet në mënyrë të drejtë dhe të balancuar.
- 2** Mediat dhe gazetarët duhet të jenë plotësisht të sigurt për vërtetësinë dhe autenticitetin e informacionit që publikojnë, duke verifikuar pretendimet nga disa burime të besueshme.
- 3** Mediat dhe gazetarët duhet që subjektet politike t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë. Ata duhet të jetë të paanshëm kur raportojnë për subjektet politike dhe kandidatët në fushatë zgjedhore, pavarësisht nga pikëpamjet dhe idetë personale politike. Neutraliteti është thelbësor për informimin e plotë dhe objektiv të qytetarëve.
- 4** Barazia në hapësirën e ofruar dhe trajtimi i aktorëve politikë duhet të reflektohen edhe në mënyrën dhe stilin e raportimit për subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre, në zgjedhjen e fotografive dhe videove që do të përdoren etj.
- 5** Mediat dhe gazetarët mund të publikojnë komente ose qëndrime redaksionale dhe analitike, por ato duhet të paraqiten qartësisht si opinione, e jo fakte.
- 6** Gjatë raportimit mediat dhe gazetarët duhet të përpiqen të shmangin fyerjen dhe shënjestrimin e politikanëve, si dhe duhet të veprojnë me kujdes të veçantë në situatat kur citohen akuza nga palët.
- 7** Nuk rekomandohet që mediat në raportimet e tyre të përcjellin vetëm njoftimet e subjekteve politike, por gjatë fushatës zgjedhore duhet të kërkojnë tema me interes publik. Po ashtu, gazetarët mund të sqarojnë njoftimet dhe deklaratat zyrtare në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për të gjithë qytetarët.
- 8** Përdorimi i rrjeteve sociale në raportim gjatë fushatës zgjedhore mund t'i ketë përparësitë e veta, siç është shpejtësia e mbledhjes së informacionit, por duhet të bëhet me kujdes. Informacioni i publikuar në rrjetet sociale duhet të kontrollohet nga disa burime. Është e domosdoshme që mediat të mos mbështeten ekskluzivisht në këto informacione.
- 9** Gjatë fushatës zgjedhore mediat dhe gazetarët duhet t'u kushtojnë vëmendje shqetësimeve dhe opinioneve që mund t'i kenë grupet e marginalizuara në shoqëri. Po ashtu, duhet të kenë kujdes në raportimin për fëmijët, si dhe të shmangin dhe të mos promovojnë gjuhë seksiste.

- 10** Mediat duhet të informojnë publikun në mënyrë
Mediat dhe gazetarët duhet të kenë kujdes gjatë
raportimit nga tubimet zgjedhore, duke mos ofruar shifra
të paverifikuara të njerëzve pjesëmarrës dhe duke
raportuar vetëm për atë që ndodh realisht.
- 11** Mediat dhe gazetarët duhet të kenë kujdes nga
përmbajtjet e gjeneruara me Inteligjencë Artificiale (AI).
Përmbajtjet e tilla duhet të identifikohen dhe të
raportohen. Ato mund të dekonstruktohen me ndihmën e
programeve të ndryshme teknologjike.
- 12** Mediat dhe gazetarët duhet të kenë kujdes kur përdorin
gjatë raportimit rezultate të sondazheve të opinionit
publik, duke i prezantuar me saktësi autorët dhe burimet,
si dhe duke bërë publike metodologjinë e përdorur,
mostrën dhe kohën e hulumtimit.
- 13** Në ditën e zgjedhjeve, mediat dhe gazetarët në terren
duhet t'i kushtojnë vëmendje parregullsisë të mundshme,
por me kujdes, sepse një parregullsi në një qendër votimi
nuk do të thotë domosdoshmërisht se zgjedhjet janë të
parregullta në tërësi.
- 14** Në ditën e zgjedhjeve, mediat dhe gazetarët duhet të
kenë kujdes në raportimin e rezultateve të votimit përpara
se të publikohen zyrtarisht, veçmas rezultatet e “exit poll”.
- 15** Mediat duhet që reklamimin politik dhe materialet e
sponzorizuara t'i dallojnë qartazi nga përmbajtja
editoriale, si dhe të tregohet qartë burimi i sponzorizimit.



Çka duhet ditur?

Fushata zgjedhore është periudha gjatë së cilës subjektet politike ia prezantojnë votuesve dhe publikut programin dhe kandidatët për zgjedhje, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Subjekt politik është një parti politike, një kandidat i pavarur, një koalicion ose një listë kandidatësh të pavarur, të certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje në përputhje me ligjin për zgjedhjet.

Interesi publik nënkupton interesin e publikut për të pasur informacion në lidhje me çështje dhe ngjarje me rëndësi të përgjithshme shoqërore, mbi bazën e të cilave qytetarët marrin vendime dhe krijojnë opinion publik.

Reklamimi politik nënkupton publikimin dhe transmetimin e reklamave, thirrjeve publike, videove dhe çdo forme tjetër të reklamimit publik të një subjekti politik.

Dezinformimi është përhapja e qëllimshme e informatave të rrejshme ose mashtruese, me qëllim manipulimi, mashtrimi apo ndikimi tek opinionin publik.

Manipulimi është një mënyrë e qëllimshme dhe e fshehtë për të ndikuar mendimet, ndjenjat apo vendimet e njerëzve duke përdorur metoda të ndryshme.

Propaganda është një formë komunikimi që ka për qëllim të ndikojë, drejtojë ose kontrollojë opinionin publik, shpesh duke përdorur informacione të përzgjedhura, të ekzagjeruara ose të njëanshme për të mbështetur një ide ose qëllim të caktuar.

Gjuha e urrejtjes është çdo shprehje, fjalim, shkrim ose veprim verbal/joverbal që sulmon apo diskriminon një person ose një grup njerëzish për shkak të etnisë, racës, kombësisë, fesë, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, moshës etj.



Çfarë tjetër duhet mbajtur mend?

Mbroni etikën e gazetarisë

Mediat dhe gazetarët duhet t'iu përmbahen kodeve të etikës, duke respektuar të drejtën e publikut për informim me kohë dhe në plotëni.

Ruajeni pavarësinë editoriale

Gazetaria e pavarur është pjesë thelbësore e çdo demokracie. Mediat dhe gazetarët duhet të kenë kujdes që votuesit të kenë qasje në informacion të paanshëm dhe të pavarur.

Verifikoni faktet

Saktësia e informacionit është prioritet gjatë raportimit për zgjedhjet, andaj mediat dhe gazetarët duhet të kujdesen që të raportojnë nga burime të besueshme dhe të verifikueshme.

Mbani tonin e duhur në raportim

Gazetarët duhet të përdorin gjuhën e duhur dhe të shmangin tonin nxitës, që mund të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve, siç është komentimi i rezultateve të sondazheve.

Kujdes gjuhën e urrejtjes

Mediat dhe gazetarët nuk duhet të ofrojnë hapësirë për politikanë që shpërndajnë gjuhë të urrejtjes, e as të publikojnë mesazhe me përmbajtje të tillë.

Planifikojeni raportimin

Mediat dhe gazetarët duhet të kenë njohuri për të gjitha detajet e procesit zgjedhor, që përfshijnë organizimin e votimit, orarin, shpalljen e rezultateve dhe të dhëna të tjera të rëndësishme.

Kujdesuni për sigurinë tuaj

Gazetarët duhet të shmangin në çdo kohë situatat e papërshtatshme dhe të kërkojnë mbrojtje në rast nevojë. Ata duhet të jenë të përgatitur për situata të ndryshme, që mund të manifestohen edhe me akte dhune dhe pasigurie.



**Funded by
the European Union**

Ky publikim është pjesë e projektit “Media Jonë”. Projekti rajonal “Media Jonë: Nismë për Avancimin e Edukimit Medial, Dialogut dhe Aktivizmit” zbatohet me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian nga organizatat partnere: SEENPM, Instituti Shqiptar i Medias, Mediacentar Sarajevo, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Instituti Malazez i Medias, Instituti Maqedonas i Medias, Shkolla e Gazetarisë Novi Sad, Instituti për Paqe dhe BIANET. Kjo përmbajtje është prodhuar me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.